



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**

MINISTRI

Nr. 1539/prot.  
5

Tiranë, më 10/04/2020

URDHËR

Nr. 256, datë 10.04.2020

**PËR DISA SHTESA DHE NRYSHIME NË URDHËRIN NR 193 DATË 20.03.2020 “PËR MBYLLJEN APO KUFIZIMIN E LËVIZJEVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të neneve 7, pika 4, dhe 15, të ligjit nr.15/201, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, si edhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

**URDHËROJ:**

Në Urdhrin nr.193 datë 20.03.2020 “Për kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë” bëhen këto ndryshime:

1. Pika I riformulohet si vijon:

“1. Lejohen të kryejnë aktivitetin e tyre vetëm në fashën orare 05:00 – 17:30, duke filluar nga dita e hënë, datë 13.4.2020, pikat e shitjes së produkteve ushqimore, me pakicë dhe shumicë, pikat e tregtisë së barnave, produkteve mjekësore dhe institucionet financiare.

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1\1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Hyrja në aktivitete e përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhëri lejohet vetëm për një person, të autorizuar, për çdo familje për kryerjen e shpenzimeve familjare ditore. Autorizimi do të jetë vetëm një herë në ditë dhe do të ketë një afat prej 90 minutash, gjatë fashës orare 05:00 deri në 17:30;

Hyrja në të gjitha dyqanet/njësitet tregtare që lejohet të hapen duhet të bëhet me radhë, duke ruajtur distancën e sigurisë prej 1.5 m nga njëri-tjetri. Çdo dyqan/njësi tregtare duhet të sigurojë maska dhe doreza për punonjësit gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe solucion dezinfektues për të gjithë personat që hyjnë në ambientet e dyqanit/njësive tregtare.

3. Pika 2 riformulohet si vijon:

“2. Kufizimin e lëvizjes, në gjitha qendrat urbane të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha kategoritë (këmbësor, biçikleta, ciklomotor, motomjete dhe mjete) si dhe ndalimi i ofrimit të shërbimeve për qytetarët nga aktivitetet e lejuara, çdo fundjavë duke filluar nga e premtja ora 17:30 deri të hënën në orën 05:00. Përfshihen nga ky rregull të gjitha mjetet e transportit të mallrave dhe të produkteve ushqimore, Policia e Shtetit, Forcat e Armatosura, njësitë kritike të shërbimeve shtetërore dhe atyre të kompanive mediatike si dhe shërbimet në banesë (delivery).”

2. Fjalja e parë e pikës 3 riformulohet si vijon:

“Ndalohet ofrimi i shërbimit ndaj qytetarëve nga të gjitha aktivitetet, përfshirë ato të përcaktuara në pikën 1 dhe në tabelën bashkëlidhur këtij urdhri, duke filluar nga e premtja 17.04.2020 e në vijim, nga ora 17:30 deri të hënën në orën 05:00, deri në një urdhër të dytë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**

**Ogerta Manastirliu**

